



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 34/1 Prot.

Tiranë, më 24/10/2011

Lënda: Rekomandim për **Shtëpia e Fëmijës Shkollore Shkodër**.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Shtëpia e Fëmijës Shkollore Shkodër**,

KONSTATOVA

Më datë 07//07.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, **Shtëpia e Fëmijës Shkollore Shkodër**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi Shtëpia e Fëmijës Shkollor, Shkodër nuk ka përmbushur detyrimin për njoftim sipas nenit 21, të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Ky kontrollues e ka plotësuar formularin e njoftimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me mangësitë si poshtë:

Kontrolluesi tek **Rubrika**, "Karakteristikat e sistemit të përpunimit", nuk ka deklaruar, rubrikën "përpunimi maual";

- Në këtë rast është kryer detyrimi ligjor për njoftim sipas nenit 21, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë*" por, nuk janë plotësuar në mënyrën e duhur të gjitha rubrikat e këtij formulari, neni 23 i Ligjit "*Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor*".
2. Kontrolluesi Shtëpia e Fëmijës Shkollore Shkodër nuk ka rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin dhe as seksione të veçanta për mbrojtjen e të dhënave personale në rregulloren ekzistuese.
 - Në këtë rast nuk respektohet neni 27/1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" "*...Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi...*
 - Nuk respektohet neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" "*Konfidencialiteti i të dhënave*".
 3. Ky kontrollues, për ecurinë e zhvillimit dhe trajtimit të fëmijëve, mban në një dosje, e cila emërtohet "Dosje Këshillimi", të dhëna që janë të përcaktuara në VKM-së nr.510, datë 24.11.1997. Grupi i kontrollit konstatoi se, përveç këtyre të dhënave nga ky kontrollues grumbullohen grumbullohen dhe të dhëna të tjera si:
 - Biseda me mësuesin;
 - biseda me prindërit;
 - interesat dhe aftesitë;
 - Sjellja sociale në shkollë;
 - Qëndrimi ndaj shkollës;
 - agresiviteti;
 - aftesia për të shprehur dëshirat, nevojat, ndjenjat;

- mekanizmat e përballimit të stresit;
- marrëdhëniet me prindërit;
- marrëdhëniet me moshatarët;
- problemi që paraqet nxënësi;
- vlerësimi i psikologut;
- të dhëna mbi zhvillimin dhe pjekurinë seksuale;
- kontrollimi i ndjenjave, e të tjera si këto të fundit.

Në lidhje me këto të dhëna, vlerësojmë që të dhëna si **-agresiviteti; -zhvillimi dhe pjekuria seksuale; -kontrollimi i ndjenjave** për këta fëmijë biologjik të braktisur dhe socialë nuk duhet të mblidhen pasi, në këtë rast tejkaloheq qëllimi i mbledhjes së tyre.

Gjithashtu, u konstatua se ky kontrollues harton planin personal të arsimimit të fëmijës dhe grumbullon të dhënat e mëposhtme:

- Emri, mbiemri, datëlindja gjinia;
- besimi fetar;**
- Grupi etnik;**
- shkolla dhe adresa e institucionit të kujdesit;
- gjuha;
- Data e hyrjes në këtë shkollë dhe masat për transportin nga shkolla;
- emri dhe adresa e doktorit;
- ndonjë çështje mjekësore, që shkolla duhet ta dijë.

Siaps VKM nr.209, datë 12.04.2006 “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe private, të përkujdesit shoqëror”, Kreu i I, nuk është parashikuar të grumbullohen të dhënat mbi besimin fetar dhe grupimin etnik.

- Në këto raste nuk është zbatohet neni 5 pika1/c i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim”,...

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

R E K O M A N D O J

1. Në zbatim të neneve 21, 22, 23 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi, kontrolluesi Shtëpia e Fëmijës Shkollore Shkodër, të riformulojë Formularin e njoftimit duke plotësuar tek Rubrika, “Karakteristikat e sistemit të përpunimit” rubrikën “përpunimi manual”;

2. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi Shtëpia e Fëmijës Shkollore Shkodër duhet të hartojë rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.
3. Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi Shtëpia e Fëmijës Shkollore Shkodër, në Formularin Plan personal i Arsimimit, Seksioni I të heqë të dhënat besimi fetar; - grupi etnik; Gjithashtu nga “Dosje Këshillimi” të heqë të dhënat: agresiviteti; - zhvillimi dhe pjekuria seksuale; - kontrollimi i ndjenjave

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

